



ANEKS Nr. 1 i Rregullores se UE

MBI MODALITETET DHE STANDARTET E REKRUTIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

- HAPJA E KONKURIMIT

- Vendet e punës për personelin akademik të brendshëm dhe të jashtëm, duhet të fitohen me konkurs dhe mbi bazën e kontratës së punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi (neni 50 i Ligjit nr. 9741 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar), statutin dhe rregulloren e njërive të institucionit.
- Konkurrimi duhet të organizohet nga njësitë përkatëse (Dekanati ose Departamenti), me kërkesën e këtyre të fundit, sipas domosdoshmërisë që i paraqitet, pasi kanë marrë miratimin e Rektoratit dhe të Këshillit të Administrimit për ndryshimet e nevojshme strukturore (kur është e domosdoshme), ose kur kërkojnë të zëvendësojnë personel akademik të larguar për shkaqe të ndryshme.
- Gjithashtu konkurrimi kërkohet dhe miratohet nga Rektorati në konsultim me Zyrën e Personelit dhe zhvillohet pranë njësisë përkatëse, kur ky i fundit konstaton raste të marrjes në marrëdhënie pune të personelit akademik që nuk plotëson kushtet e domosdoshme, pa i hequr të drejtën e marrjes pjesë në konkurrim:
 1. Kur lloji i diplomës nuk përputhet me specialitetin ose fushën ku ushtron kompetencën akademike.
 2. Kur i punësuar nuk plotëson kushtet e mesatares dhe për një periudhë 2-vjeçare ose më shumë nuk është regjistruar në shkallët e kualifikimit ose nuk ka aktivitet shkencor.
 3. Kur i punësuar për një periudhë 5-vjeçare ose më shumë nuk është regjistruar në shkallët e kualifikimit shkencor, ose nuk ka aktivitet shkencor. (Përfshihen nga kjo punonjësit akademikë më përvojë dhe kontribute të ndryshme ndër vite).
 4. Kur i punësuar nuk ka plotësuar kushtet e kontratës së nënshkruar midis tij dhe Punëdhësit (rektoratit ose dekanatit).
- Konkurrimi duhet të zhvillohet pranë njësisë përkatëse që kërkon ose zëvendëson personelin akademik, në përputhje me modalitetet dhe procedurën e vendosur nga Senati Akademik.
- Konkurrimi i kandidatëve bëhet me dosje për kandidatët për personel part-time (të jashtëm) dhe me dosje sipas kritereve pikëzuese e intervistë për kandidatët për personel full-time (të brendshëm) dhe me kontratë. Grada Doctor dhe titujt Prof.asoc dhe Prof. e shmangin intervistën. Mungesa e kandidatit ditën e konkurimit e përjashton atë nga kjo e drejtë.
- Konkurrimi njoftohet nga Zyra e Personelit pasi kjo e fundit ka marrë të dhënat dhe kërkesat përkatëse nga departamentet fakultetet të miratuara nga rektorati, në mediat e shkruara dhe vizive lokale e kombëtare.
- Të dhënat e furnizuara nga departamentet dhe fakultete duhet të jenë të detajuara. Ato duhet të përmbajnë: a. Pozicionin e saktë për të cilin konkurrohet (pedagog, as/pedagog, lektor) b. Lëndën/ët që pretendohet të mbulohet/en nga personeli akademik. c. Sasinë e saktë të orëve që duhet të mbulohen dhe emërtimin e orëve (seminare, leksione, laboratore, praktika). Numrin e saktë të personelit akademik të kërkuar-part-time, full-time, me kontratë.

- KOMISIONI I KONKURIMIT

- Komisioni i konkurimit, që ngrihet për të vlerësuar kandidatët dhe për të përcaktuar kandidaturën fituese për punonjës akademikë part-time, duhet të kryesohet nga Përgjegjësi i departamentit dhe të përbëhet nga përgjegjësit e grupeve mësimore përkatëse plus të dërguarin e Dekanatit nga personeli akademik me gradë shkencore, me të drejtë të barabartë vote (Kryetari i komisionit dhe i dërguari i dekanatit kanë të drejtë veto).
- Komisioni i konkurimit që ngrihet për të vlerësuar kandidatët dhe për të përcaktuar kandidaturën fituese për punonjës akademikë full-time dhe me kontratë kohore ngrihet dhe funksionon në rang Fakulteti dhe kryesohet nga Dekani i fakultetit dhe përbëhet nga përgjegjësit e departamenteve të fakultetit, plus të dërguarin e rektoratit nga personeli akademik me gradë shkencore (për fusha të ndryshme mund të ketë të dërguar të ndryshëm), plus 1 punonjës akademik i degës së gjuhës së huaj (për të testuar gjatë intervistës njohuritë në gjuhët përkatëse të kandidatëve), me të drejtë të barabartë vote (përjashto kryetarin e komisionit dhe të dërguarin e dekanatit ose rektoratit).

- KRITERET E KONKURIMIT

- Kriteret e konkurimit miratohen me propozim të rektoratit në Senatin Akademik dhe janë unike dhe të domosdoshme për zbatim, për të gjitha departamentet dhe fakultetet e universitetit.

1. Për punonjës akademikë full-time (të brendshëm)

- Të ketë gradën shkencore doctor në fushën dhe specialitetin përkatës, të mbrojtur brenda ose jashtë Shqipërisë (të njohura nga Zyra përkatëse pranë Ministrisë së Arsimit) (preferohen Evropë, Amerikë) ose titujt profesor i asociuar/profesor po në këto fusha e specialitete.
- Të paktën të ketë gradën Master, të mbrojtur brenda ose jashtë Shqipërisë (të njohura nga Zyra përkatëse pranë Ministrisë së Arsimit) (preferohen Evropë, Amerikë).
- Doktoratura dhe masteri për fusha të caktuara të mbrojtura në Universitetet Evropiane me traditë dhe ato Amerikane, ka precedencë ndaj atyre të mbrojtura pranë Universiteteve shqiptare dhe vendeve të tjera fqinjë.
- Kandidatët që kanë përvojë mësimdhënie në Universitetet Evropiane dhe Amerikane kanë precedencë
- Kur kandidatët kanë grada e tituj të barabartë, konkurimi mbështetet në kontributet shkencore të gjithsecilit për fushat përkatëse. Kandidati më i favorizuari është ai që ka më shumë 1. Libra të botuar për fushën përkatëse (monografikë ose tekste mësimore) 2. Artikuj të botuara në organet shkencore prestigjioze evropiane 3. Kumtesa e referime në konferenca e seminare ndërkombëtare 4. kumtesa, referime e botime të tjera. Plotësimi më i mirë i një kushti sipas renditjes së tyre e shpall kandidatin fitues.
- Për raste të veçanta, Rektori mund të emërojë punonjës akademikë, në përputhje me parametrat që kërkohen.

2. Për punonjës akademikë me kontratë (1 ose 2 vjeçare)

- Të ketë gradën shkencore doctor në fushën dhe specialitetin përkatës, të mbrojtur brenda ose jashtë Shqipërisë (të njohura nga Zyra përkatëse pranë Ministrisë së Arsimit) (preferohen Evropë, Amerikë) ose titujt profesor i asociuar/profesor po në këto fusha e specialitete.
- Në mungesë të gradës doktor ose të titujve, të ketë gradën Master, të mbrojtur brenda ose jashtë Shqipërisë (të njohura nga Zyra përkatëse pranë Ministrisë së Arsimit) (preferohen Evropë, Amerikë) ose të kenë mbaruar të gjitha detyrimet ligjore dhe të jetë në prag të mbrojtjes së mikrotezës (të fitimit të Masterit) dhe të jetë nën 40 vjeç. Ky kriter është përjashtues.
- Doktoratura për fusha të caktuara e mbrojtur në Universitetet Evropiane me traditë dhe ato Amerikane, ka precedencë ndaj atyre të mbrojtura pranë Universiteteve shqiptare dhe vendeve të tjera fqinjë.
- Kandidatët që kanë përvojë mësimdhënie në Universitetet Evropiane dhe Amerikane kanë precedencë (kur kanë njëkohësisht dhe gradën ose titullin përkatës)
- Kur kandidatët kanë grada e tituj të barabartë, konkurrimi mbështetet në kontributet shkencore të gjithsecilit për fushat përkatëse. Kandidati më i favorizuari është ai që ka më shumë 1. Libra të botuar për fushën përkatëse (monografikë ose tekste mësimore) 2. Artikuj të botuara në organet shkencore prestigjioze evropiane 3. Kumtesa e referime në konferenca e seminare ndërkombëtare 4. kumtesa, referime e botime të tjera. Plotësimi më i mirë i një kushti sipas renditjes së tyre e shpall kandidatin fitues. Kur të gjitha kushtet janë të barabarta (për gradën doctor dhe titujt prof e prof/asoc) ose kur është master dhe prag masteri ndiqet pikëzimi i mëposhtëm.
- Kur nuk kanë gradat dhe titujt e përmendur, kandidatët duhet të zotërojnë një Diplomë universitare, në fushën dhe specialitetin përkatës, të Universiteteve shqiptare, të Integruar dhe të Nivelit të dytë ose ato të huaja (të njohura nga Zyra përkatëse pranë Ministrisë së Arsimit) dhe të nën 35 vjeç. Ky kriter është përjashtues.
- Të kenë përvojë mësimdhënie në fushën përkatëse mbi 3 vjeçare
- Pikëzimi bëhet në bazë të këtyre koeficientëve:
 - Nota mesatare e përgjithshme të jetë mbi 8 (për çdo 0,1 notë = 0.5 pikë). Ky kriter është përjashtues.
 - Nota mesatare e specialitetit të jetë mbi 8.5 (për çdo 0,1 notë = 1 pikë). Ky kriter është përjashtues.
 - Master në profilin e kërkuar i përfunduar (30 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar i përfunduar në Universitetet Evropiane me traditë dhe Amerikane (35 pikë)

- Master në profilin e kërkuar në vazhdim, me provime të përfunduara në pragmbrojtje mikroteze (20 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar i përfunduar në Universitet Evropiane me traditë dhe Amerikane (35 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar në vazhdim, me provime të përfunduara në pragmbrojtje mikroteze në Universitetet Evropiane me traditë dhe Amerikane (25 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar, në vazhdim me provime të papërfunduara (1 provim = 2 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar, në vazhdim me provime të papërfunduara në Universitet Evropiane me traditë dhe Amerikane (1 provim= 3 pikë)
 - Botime monografike dhe tekste mësimore individuale të fushës përkatëse (1 botim = 15 pikë)
 - Botime monografike dhe tekste mësimore me bashkautor të fushës përkatëse(1 botim = 10 pikë)
 - Botime monografike dhe tekste mësimore individuale jo të fushës përkatëse (1 botim = 4 pikë)
 - Botime monografike dhe tekste mësimore me bashkautor jo të fushës përkatëse(1 botim = 2 pikë)
 - Botime në organe shkencore kombëtare për fushat përkatëse (1 botim = 5 pikë)
 - Botime në organe shkencore evropiane e amerikane për fushat përkatëse (1 botim = 10 pikë)
 - Botime në organe të ndryshme të karakterit divulgativë dhe jo të fushës përkatëse (1 botim =1 pikë)
 - Kumtesa ose referate në konferenca shkencore kombëtare (1 kumtesë = 4 pikë)
 - Kumtesa ose referate në konferenca shkencore ndërkombëtare (1 kumtesë = 7 pikë)
 - Kurs pasuniversitar i profilit në organizma shkencorë të licencuar (1 kurs = 5 pikë)
 - Kurs pasuniversitar jo i profilit në organizma shkencorë të licencuar (1kurs = 1 pikë)
 - Gjuhë e huaj e mbrojtur me provim të nivelit ndërkombëtar (1 gjuhë = 6 pikë)
 - Gjuhë e huaj e mbrojtur me provim të nivelit pasuniversitar me notë mbi 8 (1 gjuhë = 4 pikë)
 - Gjuhë e huaj e mbrojtur me provim të nivelit pasuniversitar me notë nën 8 (1 gjuhë = 2 pikë)
 - Gjuhë e huaj e mbrojtur me provim jo të nivelit pasuniversitar (1 gjuhë = 1 pikë)
 - Përvojë akademike si asistente pranë fakultetit për fushën përkatëse e dëshmuar në mënyrë dokumentare nga pedagogu si efikase dhe e arrirë. (1 vit = 3 pikë)
 - Përvojë akademike si asistente pranë fakultetit për fushën përkatëse jo e dëshmuar në mënyrë dokumentare nga pedagogu si efikase dhe e arrirë. (1 vit = -2 pikë)
- i. Intervista e zhvilluar ndikon në përzgjedhjen e kandidatëve pavarësisht pikëzimit të tyre.

3. Për punonjës akademikë part-time (të jashtëm)

- a. Të ketë gradën shkencore doctor në fushën dhe specialitetin përkatës, të mbrojtur brenda ose jashtë Shqipërisë (të njohura nga Zyra përkatëse pranë Ministrisë së Arsimit) (preferohen Evropë, Amerikë) ose titujt profesor i asociuar/profesor po në këto fusha e specialitete.
- b. Në mungesë të gradës doktor ose të titujve, të ketë gradën Master të mbrojtur brenda ose jashtë Shqipërisë (të njohura nga Zyra përkatëse pranë Ministrisë së Arsimit) (preferohen Evropë, Amerikë), ose të kenë mbaruar të gjitha detyrimet ligjore dhe të jetë në prag të mbrojtjes së mikrotezës (të fitimit të Masterit) dhe të jetë nën 40 vjeç.
- c. Doktoratura për fusha të caktuara e mbrojtur në Universitetet Evropiane me traditë dhe ato Amerikane, ka precedencë ndaj atyre të mbrojtura pranë Universiteteve shqiptare dhe vendeve të tjera fqinjë.
- d. Kandidatët që kanë përvojë mësimdhënie në Universitetet Evropiane dhe Amerikane kanë precedencë (kur kanë njëkohësisht dhe gradën ose titullin përkatës)
- e. Kur kandidatët kanë grada e tituj të barabartë, konkurrimi mbështetet në kontributet shkencore të gjithsecilit për fushat përkatëse. Kandidati më i favorizuari është ai që ka më shumë 1. Libra të botuar për fushën përkatëse (monografikë ose tekste mësimore) 2. Artikuj të botuara në organet shkencore prestigjioze evropiane 3. Kumtesa e referime në konferenca e seminare ndërkombëtare 4. kumtesa, referime e botime të tjera.
Plotësimi më i mirë i një kushti, sipas renditjes së tyre, e shpall kandidatin fitues. Kur të gjitha kushtet janë të barabarta (për gradën doctor dhe titujt prof e prof/asoc), ose kur është master dhe prag masteri, ndiqet pikëzimi i mëposhtëm.
- f. Kur nuk kanë gradat dhe titujt e përmendur, kandidatët duhet të zotërojnë një Diplomë universitare, në fushën dhe specialitetin përkatës, të Universiteteve shqiptare, të Integruar dhe të Nivelit të dytë ose ato të huaja (të njohura nga Zyra përkatëse pranë Ministrisë së Arsimit) dhe të jetë nën 35 vjeç. Ky kriter është përjashtues.
- g. Të kenë përvojë mësimdhënie në fushën përkatëse mbi 2 vjet

h. Pikëzimi bëhet në bazë të këtyre koeficientëve:

- Nota mesatare e përgjithshme të jetë mbi 8 (për çdo 0,1 notë = 0.5 pikë). Ky kriter është përjashtues.
 - Nota mesatare e specialitetit të jetë mbi 8.5 (për çdo 0,1 notë = 1 pikë). Ky kriter është përjashtues.
 - Master në profilin e kërkuar i përfunduar (30 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar i përfunduar në Universitetet Evropiane me traditë dhe Amerikane (35 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar në vazhdim, me provime të përfunduara në pragmbrojtje mikroteze (20 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar i përfunduar në Universitetet Evropiane me traditë dhe Amerikane (35 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar në vazhdim, me provime të përfunduara në pragmbrojtje mikroteze në Universitetet Evropiane me traditë dhe Amerikane (25 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar, në vazhdim me provime të papërfunduara (1 provim = 2 pikë)
 - Master në profilin e kërkuar, në vazhdim me provime të papërfunduara në Universitet Evropiane me traditë dhe Amerikane (1 provim = 3 pikë)
 - Botime monografike dhe tekste mësimore individuale të fushës përkatëse (1 botim = 15 pikë)
 - Botime monografike dhe tekste mësimore me bashkautor të fushës përkatëse (1 botim = 10 pikë)
 - Botime monografike dhe tekste mësimore individuale jo të fushës përkatëse (1 botim = 4 pikë)
 - Botime monografike dhe tekste mësimore me bashkautor jo të fushës përkatëse (1 botim = 2 pikë)
 - Botime në organe shkencore kombëtare për fushat përkatëse (1 botim = 5 pikë)
 - Botime në organe shkencore evropiane e amerikane për fushat përkatëse (1 botim = 10 pikë)
 - Botime në organe të ndryshme të karakterit divulgativë dhe jo të fushës përkatëse (1 botim = 1 pikë)
 - Kumtesa ose referate në konferenca shkencore kombëtare (1 kumtesë = 4 pikë)
 - Kumtesa ose referate në konferenca shkencore ndërkombëtare (1 kumtesë = 7 pikë)
 - Kurs pasuniversitar i profilit në organizma shkencorë të licencuar (1 kurs = 5 pikë)
 - Kurs pasuniversitar jo i profilit në organizma shkencorë të licencuar (1 kurs = 1 pikë)
 - Gjuhë e huaj e mbrojtur me provim të nivelit ndërkombëtar (1 gjuhë = 6 pikë)
 - Gjuhë e huaj e mbrojtur me provim të nivelit pasuniversitar me notë mbi 8 (1 gjuhë = 4 pikë)
 - Gjuhë e huaj e mbrojtur me provim të nivelit pasuniversitar me notë nën 8 (1 gjuhë = 2 pikë)
 - Gjuhë e huaj e mbrojtur me provim jo të nivelit pasuniversitar (1 gjuhë = 1 pikë)
 - Përvojë akademike si asistente pranë fakultetit për fushën përkatëse e dëshmuar në mënyrë dokumentare nga pedagogu si efikase dhe e arrirë. (1 vit = 3 pikë)
 - Përvojë akademike si asistente pranë fakultetit për fushën përkatëse jo e dëshmuar në mënyrë dokumentare nga pedagogu si efikase dhe e arrirë. (1 vit = -2 pikë)
- i. Për personeli që do mbulojë praktikat ose laboratorët në degë të ndryshme, kriteret kryesore janë përvoja e punës dhe mesatarja e përgjithshme e diplomës e cila duhet të jetë mbi 8 (nga kjo mund të përjashtohen praktikat e infermierisë).

-ZHVILLIMI I KONKURIMIT

Për kandidatin

- Kandidati, pasi është njoftuar në media, duhet të paraqitet në Zyrën e Personelit për të tërhequr formularin e domosdoshëm, i cili i jep të drejtën të marrë pjesë në konkurrim.
- Formulari plotësohet nga të gjithë kandidatët për të gjitha llojet e punësimit, part-time, full-time, me kontratë, pa gabime, sipas kërkesave dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar.
- Ai paraqitet në konkurrim në datën e njoftuar në media, ose në rrugë të ndryshme nga institucioni. Mosparaqitja i heq të drejtën e konkurrimit.
- Formularin së bashku me dokumentacionin e mbyll në një zarf, të cilin e dorëzon në Zyrën e personelit tre ditë përpara datës së zhvillimit të konkurrimit. Zarf i duhet të jetë i mbyllur dhe firmoset nga kandidati dhe Përgjegjësi i zyrës së personelit në momentin e marrjes në dorëzim. Kandidati duhet të pajiset me një vërtetim kundrejt tarifës përkatëse për regjistrimin e bërë. Tarifat përcaktohen sipas ligjeve në fuqi.

- Për intervistën ai duhet të jetë i gatshëm t'i përgjigjet pyetjeve të ndryshme në shqip dhe gjuhë të huaj dhe njëkohësisht të përgatisë dhe të referojë, para komisionit, një temë problematike që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë nga ana akademike.
- Pas njoftimit për fitimin e pozicionit për personel akademik, kandidati duhet të kontaktojë menjëherë Përgjegjësën e departamentit dhe Dekanin, për të ndjekur hapat e nevojshëm deri në nënshkrimin e kontratës.

Për komisionin

- Komisioni përkatës njoftohet për datën e orën e saktë nga kryetari i komisionit tre ditë përpara zhvillimit të konkurimit.
- Komisioni tërheq dokumentacionin e kandidatëve me proces verbal në Zyrën e Personelit para momentit të zhvillimit.
- Komisioni hap zarfet konkurrues në prani të kandidatëve dhe realizon pikëzimin e tyre dhe intervistat sipas rasteve të paraqitura.
- Komisioni realizon klasifikimin pikëzues dhe voton intervistat pa praninë e konkurruesve. Kryetari i komisionit dhe i dërguari i rektoratit ose dekanatit kanë të drejtën e vetos.
- Kandidatët njoftohen në rrugë të ndryshme (tel, e-mail) për fitim ose jo të pozicionit të kërkuar për personel akademik, pasi ky ka kaluar dhe etapat e miratimit, brenda 10 ditëve nga data e zhvillimit të konkursit.

UNIVERSITETI “ALEKSANDER XHUVANI” ELBASAN
FAKULTETI _____
DEPARTAMENTI _____

Formular Aplikimi për Personel Akademik të brendshëm, me kontratë dhe të jashtëm

1. Pozicioni për të cilin aplikoni (fusha, lënda, i brendshëm, me kontratë ose i jashtëm)		
2. Gjeneralitet		
Emri:	Atësia:	Mbiemri:
Datëlindja:	Nënshtetësia:	Gjendja civile: <input type="checkbox"/> Beqar <input type="checkbox"/> Martuar
3. Të dhënat e kontaktit		
Nr. i telefonit fiks:	Nr. i telefonit celular:	
Adresa e e-mailit:		
Adresa postare:		
4. Arsimi		
4.1 Arsimi i Lartë		
Emri i Universitetit:		
Fakulteti:		
Dega:	Profili:	
Nota mesatare e përgjithshme:	Viti i fillimit:	Viti i mbarimit:
Nota mesatare e specialitetit:		
Adresa postare e Universitetit:		
4.2 Studimet pas-universitare (Master)		
Emri i Universitetit:		
Fakulteti:		
Dega:	Profili:	
Nota mesatare e përgjithshme:	Viti i fillimit:	Viti i mbarimit:
Tema:		
Adresa postare e Universitetit:		
4.3 Doktoratura (Ph.D.)		
Emri i Universitetit:		

Fakulteti:			
Dega:		Profili:	
Nota mesatare e përgjithshme:		Viti i fillimit:	Viti i mbarimit:
Tema:			
Adresa postare e Universitetit:			
4. Kualifikime të tjera pas-universitare (3 të fundit më të vlerësuarat)			
Koha	Emri trajnimit / certifikatës / dëshmisë	Vendi	
5. Publikime Shkencore (3 të fundit më të vlerësuarat)			
Tema	Revista	Vendi	Viti
1.			
2.			
3.			
6. Gjuha e huaj (Niveli: Mjaftueshëm, Mirë, Shumë mirë)			
	E folur	E shkruar	Kuptueshmëria
1.			
2.			
3.			
7. Eksperinca në punë (5 vitet dhe/ose 4 pozicionet e fundit)			
Nga – Deri	Adresa e punëdhënësit	Pozicioni dhe përshkrimi	
8. Përshkruani të kaluarën ligjore			
9. Filozofia e mësimdhënies dhe çfarë dëshironi ju të bëni për degën dhe për fakultetin ku pretendoni të jeni :			

10. A e shihni te mundur te arrini kualifikimet e duhura që të detyron ky vend pune për një periudhë 5-vjeçare? Nëse po/jo, jepni arsyet. Përcakto në vija të përgjithshme planet kërkimore – shkencore dhe të publikimeve (Jo më shumë se 20 fjali)

11. Pse ju intereson kjo punë dhe cilat janë pikëpamjet tuaja për rolin e pedagogut?

12. A keni punë, apo angazhime të tjera që mund t’ju pengojnë për ta realizuar këtë punësim me standarde të larta?

Nënshkruaj se sa më sipër mbaj përgjegjësi për saktësinë e informacionit dhe se jam i/e gatshëm të provoj atë në rast se më kërkohet nga ana e personave përgjegjës të Universitetit “A. Xhuvani” Elbasan. Jam në dijeni se pasaktësia e informacionit (qoftë edhe pa paramendim) më heq të drejtën për të më marrë në konsideratë aplikimin e mësipërm për personel akademik.

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Aplikantit)

(Data e Nënshkrimit: DD/MM/VVVV)

-MIRATIMI I FITUESVE

- Kandidatura/t fituese, për personel akademik full-time dhe me kontratë, duhet t'i përcillet, nga komisioni me vendim të posaçëm të detajuar, Dekanatit për miratimin paraprak dhe me tej Rektoratit për miratimin përfundimtar.
- Kandidatura/t fituese, për personel akademik part-time, duhet t'i përcillet nga komisioni me vendim të posaçëm, së bashku me tabelën pikëzuese përkatëse të detajuar sipas çdo kriteri, Dekanatit për miratimin paraprak dhe me tej Rektoratit i cili pasi e konstaton e miraton përfundimisht.
- Marrëdhëniet juridike të punës duhet të rregullohen mbi bazën e kontratës së lidhur, duke respektuar legjislacionin e punës në fuqi. Kontrata e punës duhet të ndërtohet sipas modelit të miratuar nga rektorati.
- Kontrata e punës duhet të nënshkruhet nga Rektori, për personelin akademik të brendshëm (full-time), nga Dekani, për personelin akademik të jashtëm (part-time), pasi të jetë marrë dhe aprovimi për fituesin nga rektorati.